ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-21-5823-2-1-1** dhe nr i brendshem **622-21-146-211**

Sa i përket tenderit për: **Mirmbajtja dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Komunën e Prizrenit I Mirmbajtja dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Komunën e Prizrenit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ARBOR GROUP SH.P.K. & GLOBI - M.I. SH.P.K.

(Shënoi emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Skenderbeu p.n.

(Adresa)

Kamenice, Kosovë **62000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

044 77 11 44

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Granit Berisha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

arborgroupks@gmail.com

(Adresa elektronike)

22.11.2021

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. "ARBOR GROUP" KAMENICE

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin ne te cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi per dhënie te Kontratës" apo "Njoftimi per Rezultatet e Konkursit te Projektimit", afatin e fundit per dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit te procesit per Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri per dhënie te kontratës:

1. Njoftimi per kontrate i dates 01.09.2021.
2. Dosja e tenderit e dates 01.09.2021.
3. Procesverbali i hapjes i dates 11.10.2021.
4. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i dates 26.10.2021.
5. Kerkesa per rishqyrtim e dates 29.10.2021.
6. Vendimi i AK-së per Arbor Group ku Aprovohet kerkesa per rishqyrtim dhe lenda kthehet ne rivleresim i dates 02.11.2021.
7. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i dates 08.11.2021.
8. Kerkesa e dyte per rishqyrtim e dates 12.11.2021.
9. Vendimi i AK-se mbi refuzimin e kerkeses se dyte per rishqyrtim i dates 18.11.2021.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐		Jo	☐

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kerkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x	Jo	

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi

dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. E ne rastin konkret AK e ka shkelur kete nen pasi qe ne menyre te padrejte ka rekomanduar per kontrate OE që nuk i ka plotesuar kerkesat e AK-se.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Qellimi i ketij neni eshte qe Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndersa ne rastin konkret AK ka rekomanduar per kontrate OE te pa pergjegjeshem ku neve nuk jemi trajtuar barabarte dhe jemi dsikriminuar pasi qe i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e AK-se jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, gjithashtu AK nuk na ka trajtuar ne menyre te barabarte pasi qe nuk ka kerkuar kurrfar sqarimi nga ana e tyre per oferten tone ndersa ne nuk kemi dijeni se AK a ka kerkuar sqarime nga OE i rekomanduar prap per kontrate pasi qe ne kerkesen tone te pare per rishqyrtim te cilen na ka aprovuar AK e ka pranuar se kan rekomanduar nje OE te pa pergjegjeshem, ndersa ne kerkesen tone te dyte per rishqyrtim nuk na kane shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

59.2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen

ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

AK kete nen nuk e ka zbatuar ne menyre te drejte pasi qe nuk ka kekuar sqarim lidhur me nje ing. Por vetem na ka eliminuar edhe pse e kemi patur pjese te stafit dhe me deshmi te pa kontestueshme gjithashtu ne kerkesen tone te dyte per rishqyrtim AK-se ja kemi ofruar provat lidhur me dilemat e tyre.

Gjithashtu AK ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se pasi qe nuk i ka kryer ne menyre te drejte **Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, ku ka rekomanduar per kontrate nje OE qe nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.**

59.3 Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.

Ne rastin konkret OE i rekomanduar per kontrate e ka tejkaluar vleren per me shume se 2% te vleres totale te ofertes dhe AK ka bere shkelje te ketij neni duke e rekomanduar per kontrate OE te pa pergjegjeshem.

59.4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. ***AK nuk e ka zbatuar kete nen ne menyre te drejte pasi qe OE i rekomanduar per kontrate nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit, AK me kembengulje dhe me dashje ka perseritur shkeljet ligjore e qe AK me keto veprime po kalon nga shkelja administrative ne veper penale.***

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Autoriteti kontraktues ne kete aktivitet te prokurimit ka percaktuar se kriter i dhenies eshte çmimi me i ulët pra sipas ligjit:

60.1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Mirepo AK ka vepruar ne kundershtim me kete nen pasi qe ka rekomanduar OE te pa pergjegjeshem, pra e ka shkel kriterin e vendosur vet ne NJK dhe DT..

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

72.2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me kete nen pasi qe nuk ka kerkuar informata shtese per dilemat lidhur me ing. Per te cilin na ka eliminuar.

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat perkatese te RrUOPP-se

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtrueve.*

7. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kenaqur me vendimin e AK-së te dates 18.11.2021 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit **Mirmbajtja dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Komunën e Prizrenit 1 Mirmbajtja dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në Komunën e Prizrenit**, me nr te prokurimit **622-21-5823-2-1-1** dhe nr te brendeshem: **622-21-146-211 ku AK ne menyre te vazhdueshme ka shkelur dispozitat e LPP-së, pasi qe Grupin tone te operatoreve ekonomik e ka eliminuar padrejtesisht dhe ne menyre te kunderligjeshme ka rekomanduar per kontrate nje OE I cili nuk I ka plotesuar kerkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT, andaj** ne afatin ligjor ushtrojme kete ankese prane OSHP-se

Pretendimet tona kane te bejne me:

- Operatoret ekonomik qe kane ofertuar me cmime me te lire se Grupi jone jane te pa pergjegjeshem per kete kemi ofruar provat te bazuara ne dispozitat e LPP-se dhe RrUOPP-së (si me poshte te radhitura Pika 1.1 dhe Pika 1.2.) dhe
- Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar kunderligjeshem nga ky aktivitet i prokurimit pasi qe i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT (si me poshte e radhitur pika 2).

Pika 1.1.

1.1.1.

AK-KK Prizren ka shpallur ne menyre te kunderligjeshme OE i cili nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e vendosura vet ne NJK dhe DT pasi qe tek **Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare** 8.1 & 8.2 **Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 3.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 400.000,00 €** *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**

Ndersa Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate OE Bamirs nuk ka dorëzuar pasqyrat e qarkullimit financiar te shoqeruara me vërtetim nga banka apo te shoqeruara me deklaratat

vjetore te tatimeve te dorëzuara ne ATK, por ka dorëzuar formularet e deklarimit te TVSH ne vend te pasqyrave te qarkullimit financiar pra pasqyrat e qarkullimit financiar te kompanise nuk jane dorëzuar fare OE Bredhi ne vend te pasqyrave te qarkullimit financiar ka dorëzuar pasqyrat tremurore te tatimit dhe kontributeve. Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

AK eshte dashur ta elimonoj kete OE konform nenit 39.8 te RrUOPP-se ku thuhet:

Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.	68

1.1.2.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 €**

Dëshmia e kërkuar dokumentare **Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.**

Ndersa Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate Lisen e kontratave te dorëzuara nga OE Bamirs, perkatesisht kontrata me nr. 1 dhe 2 jane te papërfunduara, kontrata me nr. 3 eshte përfunduar me date 04.10.2021 dhe si e tille nuk vlen sepse kërkesa eshte qe projektet te jene te përfunduara ne tri vitet e fundit nga koha e publikimit te njoftimit per kontrate (02.09.2021, kontratat me nr rendor 4, 8, 9, 10, 11, 12, 13 nuk jane te natyres se njejte te punes dhe si te tilla nuk e plotesojne kerkesen e AK-se. Pra vlera e projekteve te përfunduara te kompanise Bamirs eshte 147.695,00 euro. Ndersa sipas kerkeses ne DT qe lideri te plotësoj 60% te kërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale, i bie qe lideri te kete ne kete kerkese 180.000,00 euro projekte te ngjashme te përfunduara. Kjo kerkese nuk eshte përmbushur. Po ashtu kontrata me numer 8, kontrata eshte e nënshkruar me dt. 06.05.20 ndersa referenca ka date 20.04.2020, Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

AK eshte dashur ta elimonoj kete OE konform nenit 39.8 te RrUOPP-se ku thuhet:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vleres se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

1.1.3.

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet Menaxheri i Projektit Agronom i Diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) min. 3 vite pervoje pune pas diplomimit. Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. -b. Një ingjinjer i diplomuar ose master i ndërtimtarisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. -c. nje bachelor te gjeodezise te licensuar nga AKK.

Dëshmija 2 Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë. . b. c.. Dëshmi mbi kualifikimin e stafit professional të kërkuar, dëshmi mbi përvojën, kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë project.

Ndersa Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate Bamirs ka lidhur kontrate te rregullt pune me agronomin Fitim Zyba mirëpo i njëjti nuk eshte ne listen e pagave te ATK, sipas kerkeses ne dosje te tenderit, kërkesa ka qene qe nese OE nuk e ka ne liste te pagave si te punësuar, mund te ofrohet marrëveshje bashkëpunimi per kete projekt, mirëpo jo kontrate e rregullt pune, poashtu kontrata e punes ka te meta te medha sepse nuk eshte përcaktuar as paga per agronomin, pra ne konsiderojme se kjo eshte kontrate fiktive. Po ashtu kompania Bamirs dhe Bredhi kane leshuar referenca apo vërtetime per agronomin Fitim Zyba kinse i njëjti ka udhëhequr projektet e tyre gjate viteve 2019 dhe 2020 mirepo sipas CV se agronomit del qe nga muaji i 12 i vitit 2018 deri ne muajin 07 te vitit 2020 i njëjti ka qene i punësuar prane organizates mikrofinanciare FINCA, kjo e ben te pamundur qe i njëjti te kete mbajtur 2 pozita pune me orar te plote.

Poashtu kontrata e rregullt e punes e kompanise Bredhi me gjeodetin nuk e ka te përcaktuar pagen dhe si e tille nuk mund te konsiderohet kontrate pune. Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

1.1.4.

Kërkesa 3. Të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.

Dëshmija 3. Lista e të punësuarve e paraqitur në ATK në tre muajt e fundit bashk me përshkrimi I shkurtër I vendit të punës për stafin, ose kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohzgjatja e realizimit të këtij projekti

Ndersa Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate OE Bamirs ka dorëzuar listen e ATK per 15 te punësuar mirëpo ne kete liste nuk eshte perfshire muaji i fundit, pra muaji 9, kërkesa ka qene qe te dorëzohet lista e ATK per 3 muajt e fundit, pra muaji, Gusht,Shtator, Tetor, OE Bredhi ka dorëzuar listen e ATK mirëpo mungojne kontributet per muajin e 9. Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

1.1.5.

Kërkesa 4 Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Nje (1) Makine per pastrim te rrugeve (trotuareve) me peshe deri ne 3 ton – 2 cope;

Dëshmija 4 . pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhet të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre DUD ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve

Ndersa Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate ka dorëzuar marrëveshje me disa kompani per makinat e kërkuara mirëpo asnjera nga keto nuk plotëson kushtet e kërkuara:

1. Marreveshja me Shkelqim Hoxha, struktura dhe ndertimi i makineri mundëson regjistrimin e makinerise se tille, e njëjta nuk eshte e regjistruar

2. Marreveshja me kompanine Edag, struktura dhe ndertimi i makinerise mundëson regjistrimin e makinerise se tille, e njëjta nuk eshte e regjistruar

3. Marreveshja me kompanine Dardania, makinat jane te regjistruara mirëpo tejkalojne peshen maksimale prej 3 ton ,sa eshte kërkesa ne dosje te tenderit

Pra asnjë nga makinat e ofruara nuk plotëson kushtet sepse 2 nga mund te regjistrohen por nuk jane te regjistrura dhe 2 te tjera e tejkalojne peshen e kerkuar.

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit.

1.1.6.

Kërkesa 5 OE duhet të kjetë i qertifikuar dhe i pajisur me këto standarde a. Certifikim ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune. b. ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë c. ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit .

Dëshmija 5. Certifikim ISO 45001 2018 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune. b. ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë c. ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit

Ndersa Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate ka dorëzuar certifikaten ISO 14001:2015 me afat te skaduar, certifikates i ka skaduar afati me date 27.09.2021, dhe si e tille eshte e pa vlefeshme dhe rrjedhimisht OE i rekomanduar per kontrate nuk e posedon certifikaten ISO 14001:2015.

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % lërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës

Sipas kesaj kerkese, OE lider ne kete rast kompania Bamirs duhet te kete ne pronesi 9 paisje nga 16 sa jane kërkuar, ndersa kompania Bamirs ne cilesine e liderit ka ne pronesi te veten vetem 7 paisje, 3 te tjera jane ne pronesi te anetarit tjeter te konzorciumit dhe 6 tjera jane me marrëveshje, pra ky konzorcium nuk plotëson kërkesat teknike sipas dosjes se tenderit.

1.1.7.

Paramasa e dorëzuar nga Operatori ekonomik eshte dorëzuar duke llogaritur normen 18% te tvsh edhe per produktet bujqesore, qe eshte ne kundërshtim me ligjin mbi TVSH, pra te gjitha produktet bujqesore jane te liruara nga TVSH, duke perfshire edhe drunje. Gjate analizimit dhe kalkulimit te këtij ndryshimi ne cmim, del se korrigjimi i cmimit per Tabelen e II eshte rreth 24 %. Cmimi i poentuar per tab II do te duhej te ishte 258,17 euro dhe jo 340,43 euro, pra dallimi eshte rreth 24% dhe si e tille kjo oferte duhet te refuzohet.

Gjithashtu i kemi edhe pretendimet tona lidhur me OE Berisha Com shpk me seli ne Gjakove ku edhe Ky OE eshte i pa pargjegjeshem pasi qe nuk i ka plotesuar te gjtiha kerkesate AK te publikuara ne NJK dhe DT si me poshte:

Pika 1.2.

1.2.1.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2 **Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 3.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 400.000,00 €** *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**

Ndersa ky Operatori Ekonomik i ka dorëzuar vetem deklaratat vjetore te dorëzuara ne ATK mirëpo jo edhe pasqyrat e qarkullimit financiar te kompanise, ky kusht nuk eshte plotesuar.

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

AK eshte dashur ta elimonoj kete OE konform nenit 39.8 te RrUOPP-se ku thuhet:

Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.	68

1.2.2

Kapaciteti teknik dhe professional: Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre,

vlera.minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 €

Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE-(e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.

Me përjashtim te kontrates me nr rendor 14, ne vlere 17.860,00 euro, asnjë kontrate tjeter nuk eshte e natyres se njejte

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit.

AK eshte dashur ta elimonoj kete OE konform nenit 39.8 te RrUOPP-se ku thuhet:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vleres se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

1.2.3.

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet Menaxheri i Projektit Agronom i Diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) min. 3 vite pervoje pune pas diplomimit. Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. -b. Një ingjinjer i diplomuar ose master i ndërtimtarisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. -c. nje bachelor te gjeodezise te licensuar nga AKK

Dëshmija 2. Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë. . b. c.. Dëshmi mbi kualifikimin e stafit professional të kërkuar, dëshmi mbi përvojën, kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë project.

OE ka dorëzuar nje kontrate punc me agronom Musli Mazreku, i cili ka diplomuar ne muajin 10.2018, pas kalkulimit te muajve deri ne njoftimin per kontrate del se agronomi ka pervoje pune 35 muaj dhe nuk plotëson kushtin ne DT prej 36 muajve. Po ashtu referencat per z. Musli Mazrekun nuk lidhen me natyren e punes dhe nuk eshte ofruar asnjë deshmi se agronomi ne fjale ka menaxhuar se paku nje projekt te natyres se kontrates.

Kontrata me inxhinierin e ndertimtarise permes se ciles eshte caktuar paga 200 bruto euro dhe gjeodetin i cili sipas kontrates ka page 170 bruto, jane kontrata te cilat jane pak te besueshme kur kihet parasysh tregu aktualisht, keto paga nuk jane paga as per fuqine e pakualifikuar punetore, e aq me pak per staf profesional.

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

1.2.4

3. Të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.

Dëshmija 3. Lista e të punësuarve e paraqitur në ATK në tre muajt e fundit bashk me përshkrimi I shkurtër I vendit të punës për stafin, ose kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohzgjatja e realizimit të këtij projekti

Oe ka dorëzuar listen e ATK per vitin 2021 per vetem 16 te punësuar dhe jo sipas kerkeses, mirëpo te njëjtit jane te paraqitur ne atk vetem deri ne muajin e 5 te vitit 2021 dhe jo ne vazhdim, pra ky kriter nuk eshte plotësuar, ndersa kontratat e bashkëpunimit i ka te dorëzuara vetem per 5 te punesuar

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

1.2.5.

. Kërkesa 4 Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit

Dëshmija 4 . pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhet të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre DUD ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve

Nje (1) Makine per pastrim te rrugeve (trotuareve) me peshe deri ne 3 ton - 2 cope;

ka dorëzuar nje fature per makinen per fshirje te rrugeve mirëpo e njëjta eshte e pa regjistruar, ndersa sipas ndertimit te makines ne fjale, e njëjta regjistrohet

ka dorëzuar nje dud doganor ne emer te joos krasniqi mirëpo edhepse e njëjta mund te regjistrohet, nuk eshte e regjistruar

ka dorëzuar nje dud tjeter doganor ne emer te joos kraniqi mirëpo edhe kjo makine nuk eshte e regjistruar

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

1.2.6

Cisterna per ujitje me kapacitet min.8000 litra min.2 cope- me deshmi te vellimi t te cisternes;

Kamioni me tabela 03 615 FB eshte dorëzuar me nje foto te nje cisterne mirëpo i njëjti eshte kamion kiper sipas CRA dhe nuk eshte dorëzuar ndonje deshmi e vëllimit, sipas kerkeses Kamioni me tabela 03 362 GH i plotëson kushtet

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

1.2.7

Lista e makinerise e dorëzuar nga OE nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ne DT sepse Berisha com ka dorëzuar 8 paisje ne pronesi ndersa i ka marrur ne shfrytëzim, i bie qe nuk ka ne pronesi 60% te paisjeve dhe rrjedhimisht nuk plotëson kushtin e 60% te kërkesave teknike

Si te tilla keto dokumente te ofruara nga ky OE nuk e plotesojne kerkesen e AK-se te vendosur ne dosje te tenderit, dhe rrjedhimisht ky OE eshte i pa pergjegjeshem.

1.2.8

Paramasa ne formatin xlsx qe eshte ne kundërshtim me udhëzuesin e prokurimit publik sepse e njëjta eshte dorëzuar ne formatin Excel dhe eshte e pavulosur dhe e pa nënshkruar.

E cila eshte pjese perberese e formularit te tenderit ku ne nenin 39.8 te RrUOPP thuhet se :

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Pika 2.

Nersa AK ne kundershtim me dispozitat e LPP-se na ka eliminuar ku si arsye:

1. **Kapaciteti teknik dhe profesional**

1. b. Një ingjinjer i diplomuar ose master i ndërtimtarisë me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.

Deshmit e kerkuara ; kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë project.(mungon kontrata e punes ose e bashkepunimit per kete project)

Neve sqarimin e njejte po e japim sikurse ne kerkesen per rishqyrtim te dates 29.10.2021 ku i kemi patur deshmite per kete kerkese te vendosur nga ana e AK-se vetem se AK nuk eshte munduar ti shiqoj dokumentet tona pasi qe ingjinierin ne fjale e kemi pjese te stafit te kompanise Globi - M.I. SH.P.K edhe ne Listen e pagave ne ATK te cilen e kemi dorezuar bashke me oferten tone, per me teper AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 te kerkoj sqarime shtese dhe menjeherë e kishim sqaruar kete dileme, ja kishim derguar kontraten por neve kemi vleresuar se lista e ATK-se eshte deshmi me e forte se vete kontrata e bashkepunimit pasi qe ing ne fjale eshte pjese e stafit, e jo AK te na eliminoj ne kundershtim me dispozitatt e LPP-se, per dallim nga hera e pare kontraten e bashkangjesim ne kete kerkese per rishqyrtim.

Ndersa ne vendimin e dates 08.11.2021 dhe te dates 08.11.2021, AK e ka shtuar edhe nje pike tjeter te eliminimit si me poshte:

Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet Menaxheri i Projektit Agronom i Diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) min. 3 vite pervoje pune pas diplominit ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës.

Dëshmija 2 Në pikën a. diploma e menaxherit dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi

menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë. (menaxheri I projektit nuk e ploteson kriterin Agronom I diplomuar)

e kemi sqaruar Autoritetin Kontraktues se lidhur me kete çështje ka dhene pergjigje Organi Shqyrtues i Prokurimit me vendimin 1118/20 te dates 28.01.2021 ku OSHP ka konstatuar se:

"Autoriteti Kontraktues, sa i përket menaxherit të projektit z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull "BACHELLOR I AGROEKONOMISË", ka kërkuar sqarime nga OE të cilët kanë sjellur dëshmi nga Agjencioni i Kosovës për akreditim si dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë ku në sqarimin përmes e-mailit të dt:20.11.2020 dhe Konfirminit me nr. Protkoli 2954/20, të dt:25.11.2020, Agjencia e Kosovës për Akreditim, deklaron se titulli i të lartpërmendurit është Agroekonomist i diplomuar në përputhje me Kornizën Kombëtare të kualifikimeve 6, BSc 180 ETCTS".

Per me teper AK ne vendimin per refuzim te kerkeses per rishqyrtim nuk na i ka shqyrtuar fare pretendimet tona vetem ka kthyer vendim per refuzim pa kurrfar arsyetimi por vetem i ka cekur dy pikat e eliminimit ne ate vendim dhe asgje tjeter e qe bie ne kundershtim me piken 9 te nenit 108/A te LPP-së.

Duke patur parasysh te gjitha keto shkelje nga ana e AK-se KK Prizren, kerkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së te konstatohen te gjitha keto shkelje te AK-se, te aprovohen si te bazuara te gjitha pretendimet tona lidhur me operatorin e rekomanduar per kontrate OE Bamirs, si dhe lidhur me operatorin OE Berisha Com shpk, pra te konstatohet se keta dy Operator jane te pa pergjegjeshem, te vertetohen edhe pretendimet tona dhe te konstatohet se kane qene te pa qendrueshme arsyet e eliminimit tone nga ana e AK-së dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-se te nxjerr:

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupit te Operatorëve Ekonomik ARBOR GROUP SH.P.K.; Globi - M.I. SH.P.K., Lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Mirmbajtja e dhe mbjellja e drunjeve dekorative ne Komunen e Prizrenit**" me numër të Prokurimit: **622-21-5823-211** te inicuar nga AK-KK Prizren,

II. ANULOHET njoftimi per dhenie te kontrates Lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Mirmbajtja e dhe mbjellja e drunjeve dekorative ne Komunen e Prizrenit**" me numër të Prokurimit: **622-21-5823-211**, te inicuar nga AK-KK Prizren dhe lenda kthehet ne Rivleresim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet per sigurimin e Ofertes, Shpenzimet e Avokatisë si ne pergaditjen e kerkesave per rishqyrtim ashtu edhe per pergaditjen e ankeses. Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë.

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*